**LEJLA SHAHU (DOBI)**
**NIPT K82005005S**
**Adresa: Rr.Islam Alla P.51/9, Tirane**
**Mob. +355 (0)67 35 89 854**
**e-mail:lejladobi@yahoo.com**

**Kerkese per Dokumentacion lidhur me Fondet e Perfituara dhe Shpenzimet nga Partia "Sigurise Kombetare Shqiptare" per vitin kalendarik 2018**

**Drejtuar: Z. Hazbi Bardhi**

**KRYETAR**

**Adresa : Rr. Elbasanit, P.21, Tirane**

**I nderuar Z.Kryetar,**

Bazuar ne Vendimin nr. 112, date 27.03.2019 te Komisionit Qendror te Zgjedhjeve si dhe te Kontrates se Sherbimit nr.1314/1 prot. date 24.04.2019, une Lejla Shahu, jam emeruar ne cilesine e Ekspertit Kontabel te Regjistruar per te audituar fondet e perfituara dhe shpenzimet e kryera nga "Partia Sigurise Kombetare Shqiptare", per vitin 2018.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kerkuar nga ne të auditojmë pasqyrat lidhur me Fondet e perfituara dhe shpenzimet e kryera nga partia juaj, per periudhen 01/01-31/12/2018.

Auditimi perfshin shqyrtimin mbi bazen e testeve te fakteve qe mbeshtesin shumat dhe deklarimet ne pasqyrat financiare qe perfshijne:

- ✓ librin e llogarive te subjektit,
- ✓ regjistrin e posacem te miratuar si model me vendimin nr.266 te KQZ-se, date 01.06.2009
- ✓ si dhe pasqyren e arketim pagesave.

Auditimi perfshin gjithashtu vleresimin e parimeve te kontabilitetit te ndjekura dhe vleresimet e rendesishme te bera nga drejtimi i Partise"Sigurise Kombetare Shqiptare", si edhe vleresimin e paraqitjes se pergjithshme te pasqyres.

Auditimi do të kryhet duke u bazuar në faktin që drejtuesi i subjektit zgjedhor pranon dhe kupton se ai ka përgjegjësi:

a.Për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare ne perputhje me:

- Ligjin 8580 date 17.02.2000 "Per Partite politike" ndryshuar me ligjin 10374 date 10.02.2011
- Ligjin Ligjin Nr.10019, date 29.12.2008 "Kodi zgjedhor i Republikes se Shqiperise"
- Ligjin Nr.9228 date 29.04.2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare"

b.Ti japin audituesit dokumentacionin per vitin kalendarik 2018 si vijon:

1. Burimet financiare dhe materiale
2. Shpenzimet e realizuara me dokumentacionin origjinal mbeshtetes sipas ligjeve tatimore ne fuqi
3. Subjektet e lidhura drejtperdrejt apo terthorazi apo qe kontrollohen nga partia politike
4. Kontraten e qerase apo huaperdorje te nderteses se selise se partise
5. Llogarite ne bankat e nivelit te dyte
6. Rregjistrat kontabel
7. Raportin financiar te vitit 2018
8. E te tjera qe ju i cmoni te nevojshme per auditimin e pasqyrave financiare te vitit 2018

c.Ti krijoje audituesit:

i. Të drejtën e hyrjes në të gjitha informacionet e për të cilat drejtimi është në dijeni se janë të nevojshme për përgatitjen e pasqyrave financiare sic janë regjistrimet, dokumentacioni dhe cështje te tjera;
ii. Informacion shtesë, të cilin audituesi mund ta kërkojë nga drejtimi për qëllime të auditimit; dhe
iii. Të drejtën e komunikimit pa kufizim me personat brenda subjektit nga të cilët gjykohet e nevojshme për të marrë evidencë auditimi.

Si pjesë përbërëse e procesit të auditimit, ne kërkojmë nga drejtimi që të marrim prej tij konfirmime me shkrim lidhur me paraqitjet që do të na bëhen në lidhje me auditimin.
Ju lutemi kerkojme te na vihet ne dispozicion gjithe dokumentacioni financiar per periudhen 01/01-31/12/2018 pasi ne kemi detyrimin ligjor per te depozituar ne KQZ raportin e auditimit brenda 30 diteve nga data e lidhjes se kontrates.

Bashkangjitur 1(nje) kopje e

- ✓ Vendimit nr.112, date 27.03.2019 te Komisionit Qendror te Zgjedhjeve;
- ✓ te Kontrates se Sherbimit nr.1314/4 prot. date 24.04.2019;
- ✓ dhe Letra e Angazhimit te Auditimit.

Lejla SHAHU
Audituese Ligjore

LEJLA SHAHU ( DOSI )
Auditues Ligjor
NIPT K 81205005 S
TIRANË / ALBANIA

Ju lutem firmoseni dhe na dërgoni kopjen që i bashkëngjitet kësaj letre për të treguar pranimin nga ana juaj, dhe rënien dakort për paisjen me dokumentacionin e kerkuar ne lidhje me fondet e perfituara dhe shpenzimet e fushates zgjedhore, duke përfshirë përgjegjësitë tona reciproke.

Pranuar dhe rënë dakort në emër të Partise "Sigurise Kombetare Shqiptare"

Hazbi Bradhi
Kryetar

Tirana më 02.05.2019

LEZLA SHAHU
Rr. Islam Alla, P.51/9
TIRANE




PARTIA SIGURISË KOMBËTARE SHQIPTARE

Rr. Elbasanit, P.21

TIRANË

[redacted]

RR 848 923 774 AA

(12) T-11